



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 110

Prishtinë, më 16.5.2024, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rrustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi dhe Hydajet Hyseni- Kaloshi.

**Munguan:** Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa dhe Besnik Tahiri.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Rinor Krasniqi, LVV; Lummir Murati, ZPRK; Vullnet Bugaçu, KDI; Valmire Abdullahu, EO.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-267 për letërnjoftimin;
5. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke shtuar dy pika: Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues dhe Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor. Rendi i ditës, me ndryshime, u miratua me 5 vota për dhe 1 abstenim.*

## **2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe potencoi se Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ka paraqitur 33 amendamente në Projektligjin nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se miratohet raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L- 274 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin për Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe tha se Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ka paraqitur 57 amendamente në Projektligjin nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se miratohet raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L- 225 për Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr. 08/L-267 për letërnjoftimin**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-267 për letërnjoftim dhe tha se Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ka paraqitur 13 amendamente në Projektligjin nr. 08/L-267 për letërnjoftimin. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se miratohet raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L- 267 për letërnjoftim dhe amendamentet i propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues**

**Kryetari** paraqiti raportin me amendamente Projektligjin nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues dhe tha se Komisioni Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka paraqitur 22 amendamente në Projektligjin nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me 6 vota për dhe 1 votë abstenim, miratohet raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L- 265 për regjistrin e pronarëve përfitues dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor**

Kryetari paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor dhe tha se Komisioni për Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ka paraqitur 17 amendamente në Projektligjin nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me 6 vota për dhe 1 votë abstenim, miratohet raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit Funkcional t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L- 241 për vlerësimin strategjik mjedisor dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **7. Të ndryshme**

Kryetari theksoi se kanë filluar vizitat në institucionet, të cilat bien në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion dhe një takim tashmë është zhvilluar së bashku me zëvendëskryetarin Driton Selmanaj dhe deputetët Erxhan Galushi dhe Dimal Basha, në Akademinë e Drejtësisë, për t'u njoftuar nga afër me punën që po bëjnë dhe me angazhimin që kanë, si dhe me tjerat sfida me të cilat përballen. Ndërsa, të premtën, më datë 17.5.2024, do të jetë një vizitë në Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues. Po ashtu, edhe java e ardhshme do të vazhdojë me vizita nëpër burgje dhe në institucione tjera. Në fund ftoi deputetët që brenda agjendës së tyre, t'i bashkëngjiten këtyre vizitave.

Mbledhja përfundoi në orën 9:40.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----